ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër MINISTRIA E INFRASTRUKTURES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**205-24-3725-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Vendosja e Sinjalizimit dhe pasijeve rrugore ne Autoudhen R7, Morin Gjurgjicë, segmenti Fushe Kosove- Besi si dhe R6 kryqezimi R6 R7 Rreth Rrotullimi R6 R25.2".

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Traffiks VA SH.P.K & REA SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Radovan Zogoviq, B1, C3, Hyrja 2, nr.27
(Adresa)

Prishtinë — ***10 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/191919
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Visar Muriqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@traffiks-ks.com
(Adresa elektronike)

12.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. **Data e njoftimit për kontratë:17.04.2024**
2. **Hapja e ofertave, e planifikuar:18.02.2025**
3. **Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 25.04.2025**
4. **Kërkesa për rishqyrtim dt.30.04.2025**
5. **Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.05.05.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56.3 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 41 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 17.04.2024, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 18.02.2025 ku kemi ofertuar 7 kompani.

Me dt.25.05.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë për **Lot 1 grupi i OE TSR SH.P.K.& IDK Konstruksion SH.P.K.** Për **Lot 2** është rekomanduar për kontratë **grupi i OE VIA SH.P.K.& EUROTITAN SH.P.K. & EUROKOS HOLDING SH.P.K.** Për **Lot 3** është rekomanduar për kontratë OE **RSM Company SH.P.K.**
Ne kemi ofertuar me çmimin më të lirë për Lot 1 dhe 2, ndërsa për Lot 3 me çmim më të shtrenjtë se sa OE i rekomanduar për kontratë ku jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si më poshtë.

Arsyeja e parë për eliminimin tonë është si në vijim:
Oe nuk eshte I pergjegjshem dhe nuk I ploteson kerkesat e Dosjes se tenderit dhe Njoftimit per kontrate te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne piken 3. Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se per Lot 1 900,000.00Euro, Lot 2 900,000.00Euro dhe Lot 3 780,000.00Euro. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar, sinjalizim horizontal dhe vertikal te rrugëve. Deshmia 3. Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve ose referenca duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vjeçare.
Oe nuk ka deshmuar se ka kontrata te realizuara ne lemine e kerkuar ne vlere prej Lot 1 900,000.00Euro, Lot 2 900,000.00Euro dhe Lot 3 780,000.00Euro. dhe pas kerkesave per Sqarim, Oe nuk ka arritur te sjelle deshmit e pagesave per pune te realizuara me operatoret ekonomik si nenkontraktor. Ka prezantuar gjendjen e bankes ku nuk deshmon qe ky qarkullim eshte per projektet ne fjale te prezantuara ne listen e tij, dhe nuk ka paraqitur fletepagesat ose gjendjen me numer te faturave per projektet qe ka prezantu.

Në lidhje me arsyen e lartcekur të eliminimit ju sqarojmë se e njëjta është e paqëndrueshme për faktet të cilat do ti sqarojmë në vijim:
Sa i përket kontratave, sqarojmë se neve me dt.10.04.2025 na janë kërkuar sqarime shtesë nga ana e AK-së, ndërsa në përgjigjet tona ne e kemi shpjeguar me fakte dhe dëshmi konkrete se e plotësojmë kërkesën në lidhje me kontratat e kërkuara.
Ne edhe një herë po e sqarojmë se për shërbimet që janë kryer për kompani private ne kemi bashkangjitur në ofertë kontratat dhe referencat të cilat janë dëshmi sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Sa për korrektësi po e sqarojmë edhe një herë, se në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së nuk ka qenë e përcaktuar që për kontratat e realizuara më kompani private të ofrohen transaksionet bankare apo ndonjë dëshmi tjetër. Mirëpo edhe përkundër këtij fakti ne sa për qartësi dhe korrektësi kemi bashkangjitur në sqarimet tona edhe konfirmimet nga banka duke dhënë sqarime të qarta për secilën nga kontratat e prezantuara, e ku përputhen të gjitha të dhënat.

Gjithashtu kur analizohet kërkesa e dosjes së tenderit në lidhje me kontratat e përfunduara në tri vitet e fundit kuptohet qartë se në kërkesë vetëm është cekur *kontratat dhe dëshmitë në vlerën e caktuar*, ndërsa nuk është bërë ndonjë ndarje e dëshmive nëse punët apo shërbimet janë kryer për institucione publike apo private. Pra nuk ekziston një ndarje e kërkesave dhe dëshmive në këtë drejtim.
Ne, me kërkesë për rishqyrtim e kemi bashkangjitur sqarimet që i kemi dhënë gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, e po ashtu edhe tani po ua përshkruajmë dhe bashkangjesim edhe një herë sqarimin në fjalë, dëshmitë dhe konfirmimet nga banka për secilën nga kontratat të cilat i kemi prezantuar në ofertë, si në vijim:

1. Tek lista e kontratave me nr. **rendor 1** është shënuar se Traffiks ka kryer shërbime për kompaninë Octacom Prishtina Mall-vlera e kontratës 184,826.50 €.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Octacom Prishtina Mall për Traffiks Va SHPK në vlerën 188,093.00 €.

Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

2. Tek lista e kontratave me nr. **rendor 2** është shënuar se Traffiks Va SHPK ka qenë nënkontraktor i kompanisë Malsija-vlera e kontratës 120,000.00 €.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Malsija Company SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 199,194.00 €.

Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

3. Tek lista e kontratave me nr. **rendor 3, 4 dhe 8** është shënuar se Traffiks Va SHPK ka qenë nënkontraktor i kompanisë Via SHPK-vlera e kontratave: 144,361.20 €, 122,074.77 € dhe 47,891.61€.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Via SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 536,571.70€.

Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

4. Tek lista e kontratave me nr. rendor **5** është shënuar se Traffiks Va SHPK ka qenë nënkontraktor i kompanisë Joos Krasniqi Bazë SHPK -vlera e kontratës 177,441.00 €.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Joos Krasniqi Bazë SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 286,251.31€.

Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

5. Tek lista e kontratave me nr. rendor **6** është shënuar se Traffiks ka qenë nënkontraktor i kompanisë Fidani L SHPK-vlera e kontratës 70,000.02 €.

Kompania Fidani L Shpk ka kryer pagesat në dy banka në vlera të ndryshme dhe atë në Raiffeisen Bank dhe në Pro credit Bank, prandaj dëshmitë i kemi nga të dy Bankat.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Fidani L SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 10,000.00 €. Kjo shumë e pagesës është bërë në Raiffesien Bank dhe po e bashkëngjisim si dëshmi, ndërsa pagesat tjera nuk janë bërë në këtë Bankë por janë bërë në Pro Credit Bank. Edhe dëshmitë-transaksionet të derguara nga kompania po ua bashkëngjisim (Procredit bank nuk na ka ofruar konfirmim bankar sikurse Raiffeisen Bank, prandaj për atë arsye po ju bashkangjisim transaksionet bankare): **transaksionin** në vlerë prej 50,667,47 € të dt.14.12.2023, **transaksionin** në vlerë prej 4,332.58 € të dt.19.07.2024, **transaksionin** në vlerë prej 10,000.00 €, të dt.20.02.2024, **transaksionin** në vlerë prej 5, 000.00 € të dt.22.06.2024.

Vlera totale e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa në këto konfirmime të Bankave janë vendos vlerat e të gjitha transaksioneve me datat përkatëse.

6. Tek lista e kontratave me nr. **rendor 7** është shënuar se Traffiks Va SHPK ka qenë nënkontraktor i kompanisë NNT ABC SHPK -vlera e kontratës 50,000.00 €.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga NNT ABC SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 137,296.57€.
Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

7. Tek lista e kontratave me nr. **rendor 9** është shënuar se Traffiks Va SHPK ka qenë nënkontraktor i kompanisë Asfalt Corp SHPK -vlera e kontratës 19,445.00 €.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Asfalt Corp SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 20,670.25 €.
Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

8. Tek lista e kontratave me nr. **rendor 10** është shënuar se Traffiks Va SHPK ka qenë nënkontraktor i kompanisë Kosova Asfalt SHPK -vlera e kontratës 12,865.00 €.

Me këtë shkresë po ua bashkëngjitim konfirmimin bankar nga Raiffeisen Bank, ku dëshmohet bashkëpunimi profesional ndërmjet kompanive në fjalë dhe dëshmohen pagesat qa janë bërë nga Kosova Asfalt SHPK për Traffiks Va SHPK në vlerën 15,627.87 €.
Vlera e transaksioneve të cekura nga banka, është vlerë më e lartë se sa vlera e cekur në listë të kontratave, referencë dhe kontratë për shkak se ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë kompani, ndërsa Banka në këtë konfirmim e ka vendos gjithë vlerën e transaksioneve me datat përkatëse.

Duke pasur parasysh dëshmitë e cekura dhe të bashkangjitura me përgjigjen në sqarimet e kërkuara, konsiderojmë se kemi ofruar dëshmi bindëse se edhe kontratat me kompani private janë realizuar në tërësi, pavarësisht që kërkesa e dosjes së tenderit nuk ka përcaktuar që të ofrohen dëshmi transaksionet bankare për punët apo shërbimet që janë kryer me kompani private, prandaj edhe arsyeja e eliminimit bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Gjithashtu, sa për korrektësi po ua bashkangjesim për secilën nga kontratat edhe **faturat** dhe **transaksionet bankare** përmes të cilave bëhet ndërlidhja e kontratave të përfunduara nga ana jonë. Të njëjta fatura, ne me kërkesë për sqarime shtesë nuk i kemi bashkangjitur për faktin se të njëjtat fatura janë dokumente konfidenciale të kompanisë dhe si të tilla nëse eventualisht do të ekspozoheshin tek ndonjë nga OE ofertues, atëherë do të na shkaktonin dëme të mëdha. Duke pasur parasysh këto dëshmi shpresojmë shumë që OSHP të merr një vendim meritor në lidhje me ofertën tonë. Gjithashtu kërkojmë që dokumentet të cilat po i bashkangjesim me ankesë të mos i lejohet qasje ndonjë pale të tretë, pasi që nëse një gjë e tillë ndodh, atëherë ne mund të dëmtohemi. Pra këto dëshmi që po ua bashkangjesim janë dhe i cilësojmë sekret afarist.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e paqëndrueshme, pasi që ne e plotësojmë në tërësi kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata të përfunduara në tri vitet e fundit. Po ashtu arsyeja e eliminimit bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së sepse jemi eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit.

- **Arsyeja e dytë e eliminimit të kompanisë tonë është si në vijim:**

Pika 4. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1. Deshmia 4. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Deshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmit duhet te jene te dukshme.
Oe ka deshtuar te plotesoj piken 7Makine speciale per largimin e ngjyres per arsye se Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Ndersa ju keni prezantuar noterizimin e marrveshjes jo perms 2 paleve por nga 2 noter te ndryshem. Pajisja eshte e marre me qera nga Dragan Kusonic dhe avokati Trafiks Edin Gorani si perfaqesues per nenshkrim te marreveshjes, ndersa noterizimi ne anen tjeter eshte bere vetem nga ana e Drafan Kusovic ndersa per autorizim ka noterizim nga Visar Murici.

Andaj ne kete pike nuk e ploteson kerkesen e Fdt ne dosjen e tenderit.

Arsyeja e lartcekur e AK-së është e paqëndrueshme sepse ne e plotësojmë në tërësi kërkesën në lidhje me pajisjet e kërkuara për **Lot 1 dhe 2**.

Sa i përket pajisjes të cilës i është referuar autoriteti kontraktues përkatësisht pajisjes **Makinë speciale për largimin e ngjyrës**, ju sqarojmë se ne kemi autorizuar personin z. Edin Gorani, me qëllim të përfaqësimit për nënshkrimin e marrëveshjes për marrjen me qira të makinës së specifikuar në marrëveshje. Autoriteti kontraktues e ka cekur se ne kemi prezantuar noterizimin e marrëveshjes jo përmes dy palëve mirëpo nga dy noter të ndryshëm.

Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, për faktin se ne në ofertë kemi prezantuar autorizimin për z. Edin Gorani dhe noterizimin e marrëveshjes për pajisjen e kërkuar për Lot 1 dhe 2. Andaj në këtë rast në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet se ne kemi prezantuar dy marrëveshje nga dy noter të ndryshëm dhe kjo vërtetohet edhe nga dokumenti të cilin e kemi dorëzuar me ofertë.

REPUBLIKA E SERBISË

UOP-II-6180-2024

NOTERI PUBLIK

Faqe 1 (një)

Gordana Smiljanić

SOMBOR

Venac Vojvode Stepe Stepanovića nr. 11

.....KLAUZOLA PËR VERIFIKIMIN E NËNSHKRIMIT NË DOKUMENT .....

Konfirmohet se më datë 10.12.2024, (më dhjetë dhjetor të vitit dymijë e njëzet e katërdhjetë) në orën 09:41 (nëntë dyzet e një):

DRAGAN (VITOMIR) KUSONIĆ, i lindur më 07.03.1972, (më shtatë mars një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) ne vendin SOMBOR REPUBLIKA E SERBISË me banim ne vendin SOMBOR STAPARSKI PUT 005 (pesë), si perfaqesues ligjor i shoqerisë BOJA doo per prodhimin e shenjave te komunikacionit në Sombor, me seli ne magën Arsenija Čarnojevića nr. 16, Sombor, numri unazë 08046689, e ka nënshkruar këtë dokument në dorën e tij në prani të asistentit të noterit publik.

Statusi i përfaqësuesit, si dhe të dhëna të tjera për shoqërinë BOJA doo per prodhimin e shenjave te komunikacionit në Sombor, që kanë të bëjnë me emrin, selinë dhe numrin e regjistrimit të personit juridik, janë përcaktuar me kontroll personal të regjistrit publik të subjekteve afariste të Agjencisë së Regjistrimeve të Bizneseve më 10 dhjetor, 2024.....

Identiteti i kërkuesit u konstatua duke këqyrur kartën e identitetit nr. 010035727 të lëshuar nga Drejtoria e Policisë SOMBOR me 26.03.2028. (njëzet e gjashtë mars, dy mijë e njëzet e tetë).....

Dokumenti i palës/palëve, i shkruar në printer kompjuterik, i përbërë nga 3(tre) faqe/faqet, është i vërtetuar në 1 (një)kopje për nevojat e palës/palëve dhe 1 (një) kopje e vërtetuar i mbetet ushtruesit të detyrës së noterit publik.

Me vërtetimin e këtij dokumenti, noteri publik konfirmon nënshkrimin e palëve, dhe nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e dokumentit në pajtim me nenin 11, paragrafi 2 të Ligjit për vërtetimin e nënshkrimeve, dorëshkrimeve dhe transkripteve.....

Tarifa për vërtetimin e 1 (një) kopje ngarkohet në shumën e përgjithshme prej 1,260.00 (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë dinarë) me TVSH në bazë të nenit 21 të tarifës numër 8 të Tarifës së Noterisë.

NOTERI PUBLIK,

Gordana Smiljanić

SOMBOR

Venac Vojvode Stepe Stepanovića nr. 11

Gjithashtu sa për sqarim në kërkesë të dosjes së tenderit nuk specifikohet saktë që marrëveshja duhet të nënshkruhet në prani të dy palëve, mirëpo në kërkesë specifikohet *"Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit"*.

Marrëveshja është ndërmjet palëve dhe është e noterizuar dhe ky fakt është me rëndësi dhe kjo marrëveshje është konform kërkesës së dosjes së tenderit, ndërsa edhe kjo arsye e eliminimit bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së. Në këtë marrëveshje konfirmohen nënshkrimet e palëve, e që kjo do të thotë se kjo marrëveshje është valide dhe legjitime, prandaj nuk mund të eliminohemi me një arsyetim të tillë.

Këtë arsye të eliminimit ne e shohim si veprim tendencioz kundrejt kompanisë tonë, pasi që edhe jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

- **Si arsye të tretë për eliminimin tonë AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:**

Oe eshte I pa pergjgjshem per shkak se ka ofruar cmime abnomalisht te ulta Duke u bazuar ne LPP Neni Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët Ju i keni plotësuar te 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet per LOT 1 dhe LOT 2.
Kushti 1: është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 7 oferta
Kushti 2: te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte pragu 30% (mesatarja /1.3) andaj Oferta e juaj plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve
Kushti 3: pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire pragu 10% (oferta e dyte /1.1) andaj Oferta e juaj plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet
Pas Sqarimit te kerkuar nuk keni ofruar Deshmi bindese per realizimin e kontratave te mehershme me keto cmime te prezantuara si dhe sipas kontratave aktuale cmimet jane bindshem abnomalisht te uleta dhe ne kete pike jeni I pa pergjgjshem.
Verejte: Bazuar ne RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 26 Grupi i Operatorëve Ekonomik dhe MARRËVESHJE DEKLARATE per formimin e grupit 2024 ne Fuqi , ju nuk keni prezantuar te njejten marreveshje duke e ndare ne % (përqindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës dhe kjo Deklarate mungone ne oferten tuaj.
Pasi qe njoftimi per kontrate dhe dosja eshte me rregullore te vjeter po ju shenojme vetem si Verejte per arsye se te gjithe OE te tjere e kan prezantuar Marrveshjen sipas Rregullores ne fuqi.

Fillimisht ju sqarojmë se arsyetimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm për faktet si në vijim:

Në lidhje me çmimet me të cilat kemi ofertuar për Lot 1 dhe 2, neve gjatë fazës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve na janë kërkuar sqarime shtesë, ku ne i kemi kthyer përgjigje të detajuar AK-së, përmes së cilës e kemi sqaruar qartë se çmimet me të cilat kemi ofertuar janë çmime të tregut.

Në vijim ne edhe një herë po e sqarojmë me fakte konkrete se oferta jonë në asnjë mënyrë nuk mund të cilësohet si ofertë abnormalisht të ulët, pasi çmimet tona janë çmime të tregut.

Më poshtë janë sqarimet të cilat i kemi dorëzuar tek autoriteti kontraktues:
<u>Pozicioni i 1.1</u>
Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijës (anësore) gjatësore (te pa ndërprerë - plotë) nga masat e perziera plastike (multi-dot) apo ekuivalente, vijë e bardhë, ku klasa e retro-refleksionit duhet të jetë R5 (Rl≥300mcd / lx / m2), me trashësi 3mm me tolerancë +/- 10%.

Bazuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktues për aplikimin e vijës së tipit Multi Dot, informojmë se sipas specifikimeve të prodhuesve të materialeve termoplastike, për një trashësi prej 3 mm, konsumi i materialit është **4.5 kg/m²** (Bashkangjitur gjeni Technikal data sheet dhe Europan Technical Assessment për materialin termoplastike ku mund te shihni konsumin e materialit)

Duke qenë se kompania jonë është distributore zyrtare për Kosovë nga kompania Geveko markings Germany, çmimi i furnizimit me material është **0.80 €/kg**, i dëshmueshëm përmes faturave dhe dokumentacionit doganor (DUD). Prandaj kostoja për metër katror është si më poshtë:

- Për vijën me trashësi **3 mm**: 4.5 **kg/m²** × 0.80 **€/kg** = **3.60 €/m² pa tvsh**

Çmimi i ofertur për Lot 1 është 7.80 €/m² pa tvsh
Çmimi i ofertur për Lot 2 është 8.20 €/m² pa tvsh

Pozicioni i 1.2
Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijës (te mesit) gjatësore (te ndërprerë, pa ndërprerë - plotë) nga masat e perziera plastike (standarde e rrafshtë), vijë e bardhë, ku klasa e retro-refleskionit duhet të jetë R5 (Rl≥300mcd / lx / m2), me trashësi 2.5 mm deri 3 mm.

Sipas specifikimeve të prodhuesve të materialeve termoplastike, për një trashësi të vijë prej 3 mm, konsumi i materialit për sipërfaqe të rrafshët është **5 kg/m²**, çmimi i furnizimit me material është **0.80 €/kg**, i dëshmueshëm përmes faturave dhe dokumentacionit doganor (DUD). Prandaj, kostoja është si më poshtë:

Për vijën me trashësi **3 mm**: 4.17 **kg/m²** × 0.80 **€/kg** = **3.33 €/m² pa tvsh**,
Çmimi i ofertur për Lot 1 është 3.00 €/m² pa tvsh
Çmimi i ofertur për Lot 2 është 4.00 €/m² pa tvsh
Bashkangjitur gjeni faturën për furnizim nga kompania Geveko markings Germany
Pozicioni i 1.3
Furnizimi dhe punimi ne rrugë i shigjetave për lëvizje dhe shenjezimi i mbishkrimeve ne rruge (si psh. vendosja e shenjave horizontale te komunikacionit etj), me material plastikë të cilat bëhen me punë dore apo me makinë, ngjyrë e bardhë, ku klasa e retro-refleskionit duhet të jetë R5 (Rl≥300mcd / lx / m2), me trashësi 3mm me tolerancë +/- 10%.

Sipas specifikimeve të prodhuesve të materialeve termoplastike, për një trashësi të vijë prej 3 mm, konsumi i materialit për sipërfaqe të rrafshët është **5 kg/m²** çmimi i furnizimit me material është **0.80 €/kg**, i dëshmueshëm përmes faturave dhe dokumentacionit doganor (DUD). Prandaj, kostoja është si më poshtë:

Për vijën me trashësi **3 mm**: 5 **kg/m²** × 0.80 **€/kg** = **4.00 €/m² pa tvsh**,
Çmimi i ofertur për Lot 1 është 14.0 €/copë pa tvsh
Çmimi i ofertur për Lot 2 është 18.00 €/ copë pa tvsh

Pozicioni i 1.4
Furnizimi dhe punimi i ishujve ndarës të trafikut, ishujve për hapjen dhe mbylljen e trafikut, vijave tërthore ne rruge me material plastikë të cilat bëhen me punë dore apo me makinë, ngjyrë e bardhë, ku klasa e retro-refleskionit duhet të jetë R5 (Rl≥300mcd / lx / m2), me trashësi 3mm me tolerancë +/- 10%.

Sipas specifikimeve të prodhuesve të materialeve termoplastike, për një trashësi të vijë prej 3 mm, konsumi i materialit për sipërfaqe të rrafshët është 5 kg/m², çmimi i furnizimit me material është **0.80 €/kg**, i dëshmueshëm përmes faturave dhe dokumentacionit doganor (DUD). Prandaj, kostoja është si më poshtë:

Për vijën me trashësi **3 mm**: 5 **kg/m²** × 0.80 **€/kg** = **4.00 €/m² pa tvsh**,
Çmimi i ofertur për Lot 1 është 10.00 €/m² pa tvsh
Çmimi i ofertur për Lot 2 është 10.00 €/m² pa tvsh
Pozicioni i 1.5
Shlyrja e vijave ekzistuese, pa dëmtimin e shtresës qarkullueses (asfaltit) në komplet segmentin rrugor.
Bashkangjitur gjeni ofertën nga Kompania Booja për shlyerjen e vijave ekzistuese, në bazë të ofertës së dhënë 0.75 **m² pa tvsh,**
Çmimi i ofertur për Lot 1 është 0.75 €/m² pa tvsh
Çmimi i ofertur për Lot 2 është 0.95 €/m² pa tvsh
Pozicioni i 1.6
Furnizimi dhe vendosja e primerit.

Bashkangjitur gjeni ofertën nga Kompania Swarco dhe Geveko si dhe specifikimet teknike për Primer.
Oferta **Swarco**: duke u bazuar ne specifikimet teknike te prodhueseve për 50 µm, sasia e materialit e cila rekomandohet **0.05 kg/ m²**, çmimi i ofertës **2.83 €/kg**
Llogaritja e çmimit: 0.05 **kg/ m²**, x 2.83 **€/kg** = **0.14 €/m²**
Oferta **Geveko**: duke u bazuar ne specifikimet teknike te prodhueseve për 50 µm, sasia e materialit e cila rekomandohet **0.05 kg/ m²** , çmimi i ofertës **3 €/kg**.
Llogaritja e çmimit: 0.05 **kg/ m²** x 3**€/kg** = **0.15 €/m²**
Çmimi i ofertur për Lot 1 është 0.15 €/m² pa tvsh
Çmimi i ofertur për Lot 1 është 0.18 €/m² pa tvsh

Sqarimet e lartcekura të cilat i'a kemi dërguar AK-së në përgjigjen e dhënë edhe përkundër faktit që kërkesa për sqarime e edhe tani arsyeja e eliminimit tonë nuk është e detajuar por e përgjithësuar, vlerësojmë se ne për çdo pozicion kemi dhënë përgjigje dhe sqarime, përmes të cilave vërtetohet se çmimet tona janë çmime të tregut.

Kur kemi parasysh të gjitha këto dëshmi që i sqaruam më lartë e të cilat i kemi sqaruar edhe në përgjigjjen tonë për sqarimet e kërkuara nga AK, konsiderojmë se mjaftueshëm dhe në mënyrë bindëse vërtetohet se çmimet tona janë çmime të tregut. Pra të gjitha sqarimet e lartcekura janë dhënë sipas nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik.

Pavarësisht fakteve të lartcekura, ne e kemi informuar AK se mund të pranojmë rritje të sigurimit të ekzekutimit aq sa AK-ja e sheh të arsyeshme, madje ne e kemi sqaruar se jemi të gatshëm të pranojmë **edhe 100 % rritjen e sigurimit të ekzekutimit**. Kjo gatishmëri e jona tregon që ne, jo vetëm që jemi të bindur, mirëpo jemi të sigurt që mund ta përfundojmë këtë projekt me çmimet e ofruara.

Ne kemi pasur qasje edhe në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë për Lot 1, 2 dhe 3 dhe njëkohësisht kemi pasur qasje edhe në dokumentet e OE të tjerë, ndërsa pas analizës që i kemi bërë të gjitha dokumenteve kemi ardh në përfundimin si në vijim:

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë për **Lot 1- TSR SH.P.K.; IDK KONSTRUKSION SH.P.K.**, janë të papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Grupi i OE të lartcekur janë të papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit ku është specifikuar *". Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Deshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmit duhet te jene te dukshme".*

Tek pika 3 tek aneksi 1 i dosjes së tenderit është kërkuar ***Makinë special për ngjyrë me masë plastike:***
I. Makina duhet të ketë mekanizëm për vendosjen e materialet nga plastika në gjerësi ≥15cm;
II. Makina duhet të ketë te integruar edhe shpërndarjen e fosforit;
III. Makina duhet te ketë mekanizëm për vendosjen e materialet nga plastika me trashësi, sipas specifikave teknike.
IV. Kapaciteti mbajtës i rezervuarit min 300 kg;.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë kanë prezantuar në ofertë një kontratë për marrjen me qira të pajisjes, ku në kontratën e prezantuar shënohet që vlefshmëria e kësaj kontrata nuk mund të jetë më e gjatë se 2 vite nga fillimi i kontratës. Në këtë rast siç dihet ky projekt është i paraparë për 36 muaj apo tri vite, e që i bie se marrëveshja e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është për tri vite por vetëm për dy vite, andaj si e tillë kjo marrëveshje nuk mund dhe nuk duhet që në asnjë mënyrë të merret si valide, sepse nuk është valide deri në përfundim të këtij projekti.

Gjithashtu tek noterizimi i prezantuar për marrëveshjen e lartcekur shënon se noteri nuk ka mundur të informohet për përmbajtjen e dokumentit të prezantuar sepse nuk e zotëron gjuhën e dokumentit. Njëkohësisht në dokument shënon se noterizimi nuk i referohet korrektësisë së dokumentit.

Gjithashtu nga dokumenti i noterizimit të prezantuar në ofertë e OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se noterizimi i dokumentit nuk është bërë në prani të dy palëve, mirëpo edhe përkundër këtij fakti AK-ja e ka rekomanduar për kontratë të njëjtin OE. Për arsyen e njëjtë autoriteti kontraktues na ka eliminuar neve si OE të përgjegjshëm nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se noterizimi nuk është bërë në prani të dy palëve. Në këtë rast AK-ja ka përdorur standarde të dyfishta ku neve na ka eliminuar me arsyetimin se noterizimi nuk është bërë në prani të dy palëve, ndërsa ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk ka prezantuar noterizimin e marrëveshjes në prani të dy palëve. Përderisa është rekomanduar për kontratë ky OE atëherë, kuptohet se sipas kërkesës së dosjes së tenderit, nuk është kërkuar që marrëveshja të jetë e noterizuar në prani të dy palëve, pasi që nëse një kërkesë e tillë do të ekzistonte atëherë OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 është i papërgjegjshëm dhe me çmim më të shtrenjtë se sa çmimi me të cilin kemi ofertuar ne si kompani dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë për **Lot 2- VIA SH.P.K.; EUROTITAN SH.P.K.; EUROKOS HOLDING SH.P.K.,** janë të papërgjegjshëm për faktet si në vijim:
Grupi i OE të lartcekur janë të papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit ku është specifikuar *". Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1",* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Deshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmit duhet te jene te dukshme".*
Tek pika 9 tek aneksi 1 i dosjes së tenderit është kërkuar ***Pajisje për matjen e trashësisë dhe shkallën e retro-reflektivitetit te sinjalizimit horizontal-1 copë.***

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë në dëshmitë të cilat i ka prezantuar në ofertë, shihet qartë se nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se nuk ka prezantuar dëshmi se i njëjti posedon pajisjen për matjen e trashësisë. I njëjti OE në listën e pajisjeve të prezantuara dhe në dëshmitë e dorëzuara ka prezantuar vetëm një pajisje me emër Delta LTL 2000. Në lidhje me këtë pajisje ju sqarojmë se nuk ekziston një pajisje e veçantë e cila e ka të integruar matjen e trashësisë dhe shkallën e retro-reflektivitetit të sinjalizimit horizontal. Në këtë rast për pikën 9 tek aneksi 1 i dosjes së tenderit, është dashur të prezantohen dy pajisje: Një për matjen e trashësisë dhe një pajisje për matjen e shkallën se retro-reflektivitetit të sinjalizimit horizontal, andaj përderisa OE i rekomanduar për

kontratë nuk ka prezantuar pajisjet sipas kërkesës së dosjes së tenderit kuptohet qartë se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Sa për sqarim pajisja e prezantuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë Delta LTL 2000: është një retroreflektometër portativ që mat retro-reflektivitetin në kushte të thata dhe të lagështa, mirëpo i njëjti nuk e posedon funksionin për matjen e trashësisë, pasi që siç e cekëm nuk ekziston një pajisje e vetme që kryen të dyja funksionet njëkohësisht.

Tek pika 7 e aneksit 1 po ashtu është kërkuar pajisja si në vijim: Makinë speciale për largimin e ngjyrës me masë plastike dhe te ngjashme, koka duhet te jetë nga diamanti, me presion me ujë apo ndonjë makinë me e avancuar e cila nuk e bënë dëmtimin e shtresave qarkulluese te asfaltit. **Vërejtje: Makina te dëshmohet me dokumentacion se pajisja nuk e dëmton shtresën qarkulluese te asfaltit.**

Për kërkesën e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dy pajisje sipas listës së dorëzuar në ofertë, mirëpo gjatë analizës që i kemi bërë pajisjeve të prezantuara nga i njëjti, kemi ardh në përfundim se pajisja e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që pajisja e të njëjtit e dëmton shtesën e asfaltit, ndërsa kërkesa ka qenë që duhet të prezantohet dokumentacion që pajisja nuk e dëmton shtresën qarkulluese të asfaltit.

Andaj edhe në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së.

Tek aneksi 1 i dosjes së tenderit tek kërkesa me nr.1 është kërkuar makineria: *Makinë special për ngjyrë me masë plastike:*
I. Makina duhet të ketë mekanizëm për vendosjen e materialet nga plastika në gjerësi ≥15cm;
II. Makina duhet të ketë te integruar edhe shpërndarjen e fosforit;
III. Makina duhet te ketë mekanizëm për vendosjen e materialet nga plastika me trashësi, sipas specifikave teknike.
IV. Kapaciteti mbajtës i rezervuarit min 300 kg;

OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar për makinën e lartcekur ka prezantuar një kontratë qiraje të lidhur me Shoqrinë "Comes S.R.L", ku në listën e pajisjeve e njëjta ka shënuar të dhënat e pajisjes si në vijim: ***Makine speciale per vijezime rrugore me masë plastike e tipit Hoffman H75/3000, Iveco Magirus MH440E35T, me nr. Shasie: WJMM1VPN004232698, 1243, me targa: BP 461 GT.***

Në lidhje me dëshmitë e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për pajisjen e lartcekur, ne kemi komunikuar direkt me prodhuesin Hoffman GmbH, ku kemi parashtruar pyetjen se çfarë lloji i pajisjes është makineria për të cilën është prezantuar dokumenti i lëshuar nga kompania Hoffman. I njëjti na ka kthyer përgjigjje ku na ka sqaruar se pajisja për të cilën kemi parashtruar pyetjen tonë, është pajisje për aplikimin e termoplastikës me spërkatje. Pra në këtë rast kuptohet qartë se makineria e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit, sepse në këtë aktivitet të prokurimit është kërkuar që vijat të punohen nga masat plastike të quajtura "multi-dot" dhe jo përmes spërkatjes.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë parasysh këtë fakt dhe të eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit OE të lartcekur dhe jo ta rekomandoj për kontratë edhe përkundër faktit që i njëjti është i pa përgjegjshëm. (**Sa për korrektësi bashkangjitur gjeni edhe komunikimin me prodhuesin Hoffman).**

OE i rekomanduar për kontratë **për Lot 3- RSM Company SH.P.K**, është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:
I njëjti OE është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar *"3. Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se per Lot 1 900,000.00Euro, Lot 2 900,000.00Euro dhe Lot 3 780,000.00Euro. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar, sinjalizim horizontal dhe vertikal te rrugëve"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve ose referenca duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vjeçare".*

Kur analizohet lista e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë përkatësisht tek projektet me nr.5-Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 1, janë vendosur dy kontrata të njëjta për vitin 2022 dhe 2023 në vlerat 174,264.73 euro dhe 27,832.50 euro. Për këto kontrata OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dy referenca të lëshuara nga Komuna e Prishtinës, ndërsa kur analizohen referencat e prezantuara, në të njëjtat shënon se të njëjtat janë referenca të përkohshme për një vit për shkak se kontrata është tri vjeçare.

Nga referencat e prezantuara kuptohet qartë se projekti për të cilat janë lëshuar referencat nga KK Prishtinë, nuk ka përfunduar ende, sepse sipas referencave i njëjti projekt është tre vjeçar. Në këtë rast kontrata dhe referencat e prezantuara nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që në kërkesë është specifikuar saktë që **"duhet të prezantohet lista e kontratave të realizuara përfunduara"**, andaj përderisa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar dëshmi të përfundimit të kësaj kontrate e njëjta nuk mund dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të merret parasysh. Nënshkrimi i kësaj kontrate është bërë me dt.19.09.2022, andaj përderisa e njëjta është kontratë tri vjeçare, kuptohet që e njëjta kontratë përfundon me dt.19.09.2025.

Në momentin që këto dy referenca nuk merren parasysh e të cilat kanë vlerën 448,097.23 euro OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata të përfunduara në vlerën prej 780,000.00 Euro. Në listën e OE janë prezantuar projekte në vlerë 1,132,580.88 euro, ndërsa kur kësaj vlere i largohet vlera e kontratë së pa përfunduar 448,097.23 euro, i bie që i njëjti OE ka kontrata të përfunduara vetëm 684,483.65 euro.

Nga fakti i lartcekur kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka arritur të prezantoj dëshmi në vlerën e kërkuar në DT, për kontrata të përfunduara në tri vitet e fundit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar *". Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Deshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmit duhet te jene te dukshme".*

Tek aneksi 1 i dosjes së tenderit, përkatësisht tek kërkesa nr.2 për Lot 3 është kërkuar: ***Kamion me shportë hidraulike për punë min 10.00 m të lartë.***

Në lidhje me pajisjen e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dy pajisje, mirëpo që asnjëra nga to nuk janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Pajisja në emër të kompanisë RMS SH.P.K., nuk është pajisje sipas kërkesës së dosjes së tenderi, sepse për të njëjtën nuk janë prezantuar dëshmi që i njëjti posedon shportë hidraulike min.10.00 m. Gjithashtu e njëjta pajisje është kamion kiper me vinç për pastrim të rrugëve nga b me 2 dyer dhe si e tillë nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit. Gjithashtu edhe pajisja tjetër e cila me nr.AA476OS, nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit për faktin se e njëjta nuk posedon regjistrim valid dhe njëkohësisht për të njëjtën pajisje nuk janë ofruar dëshmi në lidhje me lartësinë mbi 10.00m për shportën hidraulike.

Andaj si përfundim OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe si i tillë i njëjti është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë dyshojmë që nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën për pajisjen me nr.5 të aneksit 1, ku është kërkuar ***"Pajisje për matjen e shkallës së retro-reflektivitetit te sinjalizimit vertikal".***

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertë një faturë e cila është e pa paguar, pasi që statusi i të njëjtës është ne proces. Gjithashtu nga përshkrimi i pajisjes figuron që i njëjti ka prezantuar dëshmi vetëm një pajisje e cila nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që nuk ekziston një pajisje e vetme e cila e posedon edhe sinjalizimin horizontal dhe atë vertikal. Në dyshojmë që pajisja e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e posedon matjen e shkallës së retro-reflektivitetit për sinjalizimin vertikal, mirëpo e njëjta e posedon vetëm matjen e sinjalizimit horizontal.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 3 është e papërgjegjshme dhe si e tillë është dashur të cilësohet edhe nga ana e AK-së dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Ne me dt.05.05.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues është arsyetuar se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk ka dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë.
Në lidhje me arsyet e eliminimit, autoriteti kontraktues është përgjigjur shumë thjeshtë dhe pa asnjë arsyetim, si më poshtë:

Pas shqyrtimi te këtyre pikave te ankimimit AK edhe një here ju sqaron se qëndron sipas vendimit dhe letrës standarde te eliminimit ku edhe pas kërkesave për sqarime shtese ju nuk i keni plotësuar kushtet sipas kërkesave te përcaktuara te FDT-se. Ndërsa sa i përketë eliminimit lidhur me çmimin abnormal te ulet ju njoftojmë se për ketë janë ndjekur te gjitha procedura ligjore bazuar ne LPP, Rregulla dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik.

Kjo përgjigje nuk argumenton asgjë dhe nuk përmban asgjë më shumë se sa letra standarde për tenderues të eliminuar, prandaj nga kjo përgjigje kuptohet qartë tendenca e AK-së që me çdo kusht të na eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit pa ndonjë bazë ligjore.
Jo serioziteti i autoritetit kontraktues dëshmohet me këtë përgjigje, ku ne edhe pse i kemi argumentuar pretendimet tona ankimore përkitazi me arsyet e eliminimit, autoriteti kontraktues nuk ka shpreh gatishmëri që të analizojë detajet me dëshmi konkrete të ofruara nga ne por ka vepruar njëanshëm duke refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve tona ankimore në lidhje me papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për Lot 1, 2 dhe 3 autoriteti kontraktues është përgjigjur se këta operatorë ekonomik i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe nuk ka dhënë asnjë sqarim apo përgjigje tjetër.

Përderisa nuk është përgjigjur dhe nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve tona ankimore atëherë nënkuptohet se këta OE janë të papërgjegjshëm dhe faktikisht i bie se edhe vetë AK-së është pajtuar me këto arsye të eliminimit.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse janë rekomanduar për kontratë për Lot 1, 2 dhe 3 OE të cilët nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkojmë që të analizohen në tërësi të gjitha faktet dhe dëshmitë tona të prezantuara në këtë ankesë, pasi që jemi eliminuar nga ky aktiviteti i prokurimit edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht për Lot 1 dhe 2 jemi ofertues me çmimin më të lirë, ndërsa për Lot 3 është rekomanduar për kontratë një OE i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e grupit OE **Traffiks VA SH.P.K & REA SH.P.K.** si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (formulari B58) dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*